



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 18 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 2179 prot., datë 16.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 15, datë 03.06.1997 ka vendosur ndër të tjera: *“...Detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të rishqyrtojë çështjet e kërkesave {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}, duke i dhënë atyre mundësi të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes”.*

Nga kërkimi në fondin arkivor të Këshillit të Lartë Gjyqësor rezulton se, z. {...} ka paraqitur një kërkesë për konkurim, referuar vendit vakant të shpallur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjyqtar Ushtarak), protokolluar me aktin nr. 17/8 prot., datë 15.09.2003 në ish- Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për të cilën nuk rezulton të ketë një vendimmarrje konkrete.

Bashkëlidhur, ju vendosim në dispozicion një kopje të kërkesës nr. 17/8 prot., datë 15.09.2003 dhe vendimit nr. 15, datë 03.06.1997 të Gjykata Kushtetuese.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!